

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Falsifikim dokumentesh e shpërdorim detyre, pranga 2 ish-drejtorëve të ASHK, specialistit dhe përfituesit në Fier - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/falsifikim-dokumentesh-e-shperdorim-detyre-ne-pranga-2-ish-drejto-re-ashk-specialisti-dhe-perfituesi/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 08:36:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 08:29:37 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	956c1be0e73f9fcd5235dfdd82fd54b22aadcff042544121d73d718c18bad61a
TEKSTI	280461ed76ad5a57a5b58a2319f0f4c126a11be505bc56a74c94d9c2cb5d398b
PAMJA	27dc2eb55e35764509e4049d24a85eb89f5827ac198383dcfbd11e4cb55d6f9d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f1571fb1ae0854c3c9de93c63f3486f05a5c68776a10617a2bd4f29c8afc1db
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	08125200eaf71731bdbb8a1cab166a4681f18204dc61aa429d5ceda9de8c2ea9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f1571fb1ae0854c3c9de93c63f3486f05a5c68776a10617a2bd4f29c8afc1db>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Kuvendi i Shqipërisë BE Inteligjenca Artificiale PD

AKTUALITET | VENDI

Falsifikim dokumentesh e shpërdorim detyre, pranga 2 ish-drejtorëve të ASHK, specialistit dhe përfituesit në Fier

17 Shtator 2026 | 10:29

Prokuroria e Fierit ka dalë me një njoftim këtë të enjte ku ka bërë me dije se janë vënë në pranga 4 persona mes tyre edhe dy ish-drejtorë të ASHK-së. Në njoftim bëhet me dije se ata janë vënë në pranga për veprat penale 'Falsifikim i dokumenteve', 'Shpërdorimi i detyrës' si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale". Në kuadër të hetimeve u sekuestruan mbi 76 pasuri, me sipërfaqe totale prej 1143 hektarë tokë.

Njoftimi i plotë:

Me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier u vendos masa e sigurimit personal 'Arrëst në burg' ndaj katër shtetasve E.Sh., B.K. në cilësinë e drejtorëve të ASHK, P. Ç. specialistit, jurist, pranë ASHK dhe K.H., përfituesi i pronave nën akuzë për veprat penale 'Falsifikim i dokumenteve', 'Shpërdorimi i detyrës' si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale" të parashikuara nga nenet 186/2, 248 dhe 287, prg.2, të Kodit Penal.

Po kështu, në kuadër të hetimeve u sekuestruan mbi 76 pasuri, me sipërfaqe totale prej 1143 hektarë tokë (e barabartë me njëmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e gjashtë m2), si dhe 150.000 euro.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier gjatë hetimeve të deritanishme për procedimin penal nr. 1026 të vitit 2025, kryer në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, nëpërmjet përdorimit edhe të metodave proaktive, arriti të provojë se:

Shtetasi K.H., duke paraqitur si tituj pronësie dy vendime të falsifikuara të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier, ka arritur të regjistrojë në bashkëpronësi të tij dhe katër personave të tjerë një sipërfaqe të konsiderueshme toke prej 1,143 hektarë si dhe 150.000 Euro të ndodhur në zonat kadastrale 3301 dhe 3358, Seman i Ri dhe Sheq Marinas, Fier.

Më pas, ky shtetas, duke u paraqitur me cilësinë e bashkëpronarit dhe përfaqësuesit edhe të bashkëpronarëve të tjerë, me anë të një prokure të posaçme të falsifikuar, u ka shitur këtë tokë dy shoqërive të ndryshme.

Shtetasit E.Sh. dhe B.K., në cilësinë e drejtorëve të ASHK, Fier, dhe shtetasi P.Ç., në cilësinë

LAJMI I FUNDIT

10:30 Diskutime brenda mbledhjes së Grupit të PS, Braçe kërkon qëndrim ndaj magjistratëve: Thanë se nuk na njohin

10:25 Zbulim i rrallë në Hënë! Shkencëtarët pikasin kraterin e ri gjigant, më i madhi i formuar së fundmi në Sistemin Diellor

10:17 PS mbledhje grupi para seancës, zbulohen detaje nga mbledhja! Do lexohet në deklaratë për vendimin ndaj SHPËRNDARËSË UÇK-së
ARTIKULLIN

10:17 Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Bardhi: Duhet një qëndrim i përbashkët i të gjitha forcave politike

10:07 Deputetët e PD-së me stemën e UÇK-së në veshje, gjest solidariteti pas vendimit të Hagës

10:03 Australia dhe Zelanda e Re mund ti bashkohen Kanadasë si anëtare të asociuara të BE-së, Metsola bën propozimin

TESTIM

e specialist, jurist, pranë ASHK, Fier, ka regjistruar pasurinë e tij në bashkëpronësi të shtetasit K.H., në kundërshtim me ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën", dhe ligjin nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe VKM nr. 639, datë 16.10.2024, dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", duke mos kërkuar sipas këtyre akteve ligjore/nënligjore konfirmimin e vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier nga Agjencia e Trajtimit të Pronës, verifikim nga i cili do të rezultonte se këto vendime janë të falsifikuara.

Për më tepër, ka rezultuar se shtetasi B. K., ish drejtor i ASHK, Fier, kur ka regjistruar pasurinë nr. 3**, zk 3358, ka tejkaluar edhe sipërfaqen që sipas vendimit të falsifikuar nr. 8*, datë 20.01.1997, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pranë Këshillit të Rrethit Fier, i ishte kthyer ish-pronarit Th.S., duke përfutur për rrjedhojë shtetasi K.H. edhe një sipërfaqe tjetër të konsiderueshme toke në pronësi.

Gjithashtu, shtetasi E.SH. e P.Ç. gjatë regjistrimit të pasurive kanë ndryshuar zërin kadastral të sipërfaqes së regjistruar në pronësi të shtetasve K.H., etj, nga tokë arë në tokë pa frut, pa një akt administrativ nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Bujqësisë apo Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier.

Masat e sigurimit personal dhe pasuror u ekzekutuan nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier në bashkëpunim me shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë si të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | KOSOVË | POLITIKË | RAJONI | VENDI

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Bardhi: Duhet një qëndrim i përbashkët i të gjitha forcave politike

Kryetari i Grupit Parlamentar i PD-së, Gazmend Bardhi gjatë fjalës së tij në Konferencën e Kryetarë ka folur lidhur me vendimin e Gjykatës Speciale në...

10:17 | 17/09/2026

AKTUALITET | POLITIKË | VENDI

Deputetët e PD-së me stemën e UÇK-së në veshje, gjest solidariteti pas vendimit të Hagës

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike ka shkuar këtë të enjte në sallën e Kuvendit, duke u spikatur me një gjest simbolik. Në shenjë solidariteti me...

10:07 | 17/09/2026

AKTUALITET | POLITIKË | VENDI

Mazhoranca rrëzon kërkesën e opozitës për Komision Hetimor për kompaninë KAYO

Partia Demokratike ka bërë kërkesë këtë të enjte për ngritjen e Komisionit Hetimor për veprimtarinë e KAYO. Kërkesa u rrëzua nga mazhoranca në Konferencën e...

09:54 | 17/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara Punësimi

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakti

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.